



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **02/2025**

Data: **08 janar, 2025. Ora: 14:00**

Vendi: **Selia e KQZ**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi.

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 72/ 2024

3. Aktivitetet e Zyrës

-
- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të Zyrës për ndarjen e mjeteve nga Fondi për mbështetje për subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, për periudhën dy mujore (janar – shkurt) 2025.
-

4. Këshillat e KQZ

4.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

- 4.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve të rregullta dhe të vendvotimeve me kusht;
 - 4.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së anëtarëve të ekipeve të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit;
 - 4.1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit dhe përmbajtjes së fletëvotimeve dhe broshurave për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025.
-

5. Të ndryshme

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:** Në fillim, kryetari Radoniqi prezantoi agjendën e takimit. Pas paraqitjes së agjendës, nuk kishte pyetje, propozime tjera etj., nga anëtarët e KQZ-së. Me 11 vota për, u miratua rendi i ditës.

Në vazhdim, po me 11 vota për u miratua edhe procesverbali nr. 72/2024 nga mbledhja e KQZ.

- 2. Aktivitetet e Zyrës**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të Zyrës për ndarjen e mjeteve nga Fondi për mbështetje për subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, për periudhën dy mujore (janar – shkurt) 2025:

Besnik Buzhala, drejtor i Zyrës, tha se sipas paragrafëve 3 dhe katër të nenit 3 të rregullores nr.3/2024 mbi menaxhimin e mbikëqyrja financiare e subjekteve politike, Zyra rekomandon për miratimin e ndarjes së mjeteve materiale për 14 subjektet politike që janë të përfaqësuara në Kuvend. Fondi, nuk

ndahet për subjektin politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim ngase, KQZ vitin e kaluar mori vendim për privimin e përfitimit të këtij subjekti nga fondi.

Zyra, rekomandon ndarjen e mjeteve për 2 muaj. (Vërejtje: ka ndërprerje të incizimit në stenogram...)

Alban Krasniqi, në diskutimin e tij, pavarësisht tha se fondi të ndahet për subjektet politike ashtu siç e parashih ligji, dhe propozoi që të votohet nga KQZ për secilin subjekt në mënyrë të veçantë.

Sipas raportit të Zyrës, **Besnik Buzhala** paraqiti në total për secilin subjekt shumën e subjektit dhe për deputetët nga fondi për dy muaj:

1. Lëvizja “Vetëvendosje!”: 353, 898, 31 cent.
2. Partia Demokratike e Kosovës: 115, 932, 20 cent
3. Lidhja Demokratike e Kosovës: 91, 525, 42 cent
4. Serbska Lista: 54, 915, 25 cent
5. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës: 48, 813, 56 cent
6. KDTP: 12, 203, 39 cent

Për 8 subjektet e përfaqësuara në Kuvend që kanë vetëm 1 ulëse ose 1 deputet, përfitojnë në mënyrë të barabartë shumën prej: 6, 101, 69 cent.

Përgjatë diskutimeve, Sami Kurteshi, tha se voton kundër ndarjes së mjeteve për subjektin Lista Serbe.

Në vazhdim, kryetari Radoniqi e hodhi në votim rekomandimi i anëtarit Alban Krasniqi që, ndarja e fundit të votohet veç e veç për secilin subjekt, dhe mori vetëm 3 vota për me çka, nuk kaloi.

Më pastaj, kryetari Radoniqi kërkoi që të votohet rekomandimi i Zyrës që mjetet e ndara për subjektet politike të votohen në pako. Por, as ky rekomandim nuk kaloi sepse, për te votuan vetëm 3 anëtarë.

Kryetari Radoniqi, tha se refuzohet rekomandimi i zyrës.

4. Këshillat e KQZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve të rregullta dhe të vendvotimeve me kusht:

Arianit Elshani: Këshilli, tha z. Elshani, ka shqyrtuar këtë pikë. Përbërja e anëtarëve të rregullt në Këshillave të Vendotimeve (KV), dhe në Vendvotimet me Kusht, është: 16, 786 anëtarë. (Vërejtje: incizimi, nuk është funksional. Ky raport, nuk është bashkangjitur me agjendën e mbledhjes.)

Diskutuan: Alban Krasniqi, Gordana Llaban, Qemailj Kurtis, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj dhe, Kreshnik Radoniqi. Diskutimet e anëtarëve kishin të bënin me shtrim të pyetjeve, vërejtje dhe mospajtimeve në përbërje të anëtarëve etj. (Incizimi është i pakuptueshëm, pjesë – pjesë dhe nuk mund të ndërlidhen fjalët dhe fjalitë në koncept të qartë të diskutimeve...)

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, kush është për miratim të këtij rekomandimi ?

Me propozimet nga debati për ndryshim, me përmirësime nga vërejtjet që u shtruan në debat, me 8 vota për, 1 kundër, 2 abstenime u miratua rekomandimi i përbërjes së anëtarëve të Këshillave të Vendotimeve të Rregullta dhe, të Vendotimeve me Kusht.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së anëtarëve të ekipeve të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit:

Arianit Elshani: Një risi e këtyre zgjedhjeve janë QKN – të, dhe në këshill, i kemi shqyrtuar e miratuar edhe përbërjet e anëtarëve të ekipeve të numërimit. Subjektet politike, mund ti dërgojnë personat e njëjtë nga ekipet në Vendvotime, por mund të jenë edhe anëtarë që i nominojnë gjatë kësaj periudhe nga sot, e tutje! Kemi shqyrtuar formulën dhe janë katër anëtarë. Aty-këtu mund të jenë edhe pesë anëtarë, kur janë në pyetje edhe komunitetet e tjera në vende të caktuara. Është tabela e QKN-ve, dhe besoj ju keni pasur mundësi ta shihni e analizoni.

Si këshill, rekomandojmë ta miratoni, tha në fund z. Elshani.

Me 8 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua ky rekomandim.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit dhe përmbajtjes së fletëvotimeve dhe broshurave për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025:

Arianit Elshani: Këshilli, ka shqyrtuar edhe dizajnin dhe përmbajtjen e fletëvotimeve dhe broshurave për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025. Ne kemi edhe një rregullore të miratuar për fletëvotimet dhe broshurat ku parashihet çdo detaj, dhe ne rekomandojmë për miratim._Rekomandojmë pra për miratim, përfundoi z. Elshani.

Në vazhdim, Besnik Buzhala shpjegoi 3 ndryshime të kandidatëve në broshurë. Ibrahim Selmanaj, falënderoi Sekretariatën për punën e mirë që kanë realizuar, ndërsa Sami Kurteshi tha se, voton fletëvotimin por, pa subjektin Lista Serbe.

Me 9 vota për, dhe me 2 kundër u miratua fletëvotimi për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës që mbahen më 9 shkurt, 2025:

Në fund, kryetari Radoniqi bëri të ditur se nesër, do të thotë më 3 shkurt, fillon periudha e votimit Jashtë Vendit, që zgjatë deri më 8 shkurt, 2025.

5. Të ndryshme!

